



AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“MD BUSINESS SOLUTIONS” sh.p.k.

Sotne date **14.10. 2020**, ne **Tirane**, **Z. Marco D'ANGELO**, shtetas italian, atësia Rocco, lindur më 20.08.1975 në Bari dhe banues në Bari-Carbonara (Itali), në Via dei Caduti della Strage di Bologna n. 12/A (kodi fiskal DNG MRC 75M20 A662W), madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i martuar në regjimin pasuror të ndarjes së pasurive, mbajtës i lejes së drejtimit të automjetit nr. BA2827738M, lëshuar më 12 gusht 1994, e vlefshme akoma, i përfaqësuar me prokurë të posaçme me nr. repertori 12.553, datë 8 shtator 2020, të hartuar nga noteri italian **Domenico Amoruso**, Noter në Bari, i regjistruar në Kolegjin Noterial të Rrethit të Barit, nga **Znj. Elisa SHKURTAJ**, atësia Skënder, lindur më 23.10.1997 në Vranisht (Shqipëri) dhe banuese në Tiranë (Shqipëri), madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e pasaportës shqiptare me numër BG0258332 dhe me numër personal J76023040K, në cilësinë e *“Ortakut Themelues, te shoqerise, redakton kete akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklarohet se me vullnetin e tij të lirë e të plotë, ka vendosur të krijojë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, si më poshtë, në respektim të legjislacionit përkatës në fuqi.*

KREU I

Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti

Neni 1

Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“MD BUSINESS SOLUTIONS” sh.p.k.**

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria **“MD BUSINESS SOLUTIONS” shpk**, është person juridik i së drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur **“Shoqëria”**), e themeluar nga personi fizik i sipërpërmendur, i cili nuk përgjigjen për detyrimet e Shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e Shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Elisa Shkurtaj

Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raporti.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në adresën **Rruga" Bako Dervishaj", Nd. 8, H. 2, Ap. 6, Njësia Administrative nr. 2, 1010 Tiranë, Shqipëri.**

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra perfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

Objekti

Krijimi i website-ve, e-commerce, aplikacioneve dhe rrjeteve sociale, publicitet, katalogje, logo, marketing, studim dhe kerkim tregu, kerkim klientesh dhe furnitoresh, përpunim të dhenash, shitblerje e veshjeve, produkteve elektronike, mobiljeve, makinave etj., shërbim konsulence, menaxhim/ krijim paketash turistike dhe udhëtimesh, shërbime financiare, call center.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është **100 (njëqind) euro** dhe është i përbërë nga **1 kuotë**.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga ortakët e Shoqërisë, përkatësisht:

Z. Marco D'ANGELO, zotërues i **1 (një) kuote**, me vlerë të përgjithshme **100 (njëqind) euro**, që përbën **100 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë**.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Elisa Shkurtej




Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së Shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cënimit.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë Shoqërisë, me miratimin e Shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të Shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilesuar që kërkon ndryshimin e statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë.

Elisa
Shkurtej
Elli

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, me anë të një autorizimi, nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i Shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Elisa Shkurtej
[Signature]

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë, vendos me votat e të paktën tre të katërtave të zotëruesve të kapitalit të Shoqërisë, që janë pjesëmarrës në mbledhje.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të Shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

Neni 10

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator.

Administratore e Shoqërisë është Znj. **Elisa Shkurtaçaj**, atësia Skënder, lindur më 23.10.1997 në Vranisht (Shqipëri) dhe banuese në Tiranë (Shqipëri), madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e pasaportës shqiptare me numër BG0258332 dhe me numër personal J76023040K, e cila do të ushtrojë funksionet në këtë detyrë për një periudhë **5 vjeçare me të drejtë ripërtëritje**.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Elisa Shkurtaçaj


Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 11

Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivitetet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim; dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të Shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridikë, publik dhe/ose privat, vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për

Elisa Shkurteaj
[Signature]

të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të Shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji i'a jep shprehimisht ortakëve të Shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e Shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12 **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 13 **Prishja dhe likuidimi**


Shpërndarja ose prishja e Shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të Shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Neni 14 **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me statutin e saj dhe me dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Elisa Shkurtej


Për sa nuk parashikohet në statutin e Shoqërisë, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15
Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16
Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 3 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe. Ky akt, pasi është miratuar në parim dhe nen për nen nga Ortaku i vetëm i Shoqërisë tregtare **në krijim e sipër** (nëpërmjet përfaqësueses së tij me prokurë brenda tagrave të përcaktuara në të), nëshkruhet rregullisht prej saj në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën.


Ngarkohet administratori për depozitimin e këtyre akteve pranë QKB.

ORTAKU THEMELUES

Marco D'ANGELO

I përfaqësuar me prokurë nga

Elisa SHKURTAJ

Elisa Shkurtaj


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER NIKOLETA P. GJORDENI

N₂₀ 4325



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë **14.10.2020 (dy mije e njetzet)**, para meje Notere NIKOLETA P. GJORDENI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, MYSLYM SHYRI, NR.30, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUESI

Elisa Shkurtaç, atësia Skënder, amësia Irena, shtetas Shqiptar, lindur në Vranisht, Vlorë dhe banues në Himarë, me adresë Vranisht; Nd. 089; H. 0; Ap. 089; Horëvranisht; Vranisht; 9413; Himarë, lindur më 23/10/1997, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032733526 dhe nr. personal J76023040K.

E cila ne cilesine e perfaqesueses se vecante te **Z. Marco D'ANGELO**, shtetas italian, atësia Rocco, lindur më 20.08.1975 në Bari dhe banues në Bari-Carbonara (Itali), në Via dei Caduti della Strage di Bologna n. 12/A (kodi fiskal DNG MRC 75M20 A662W), madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i martuar në regjimin pasuror të ndarjes së pasurive, mbajtës i lejes së drejtimit të automjetit nr. BA2827738M, lëshuar më 12 gusht 1994, e vlefshme akoma, me prokurë të posaçme me nr. repertori 12.553, datë 8 shtator 2020, të hartuar nga noteri italian Domenico Amoroso, Noter në Bari, i regjistruar në Kolegjin Noterial të Rrethit të Barit, legalizuar me vule apostile nr. 736/2020, date 15 shtator 2020, në vullnet të lirë dhe të plotë, ne përbushje te tagrave te prokures se mesiperme, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noteres, "Akt Themelimi dhe Statutin" e shoqërisë ne krijim e sipër "MD BUSINESS SOLUTIONS", me ortak te vetem te perfaqesuarin **Z. Marco D'ANGELO**, bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE
NIKOLETA P. GJORDENI



11

11

Repertorio N. 12.553

PROCURA SPECIALE

REPUBBLICA ITALIANA

L'anno duemilaventi, il giorno otto del mese di settembre,

- 8 settembre 2020 -


in Bari, nel mio studio alla Via Piccinni n.51;

innanzi a me dottor Domenico Amoruso, Notaio in Bari, iscritto al Collegio Notarile del Distretto di Bari;

è presente

D'ANGELO MARCO, cittadino italiano, paternità Rocco, nato a Bari (Italia) il 20 agosto 1975 e residente in Bari-Carbonara alla via Caduti della Strage di Bologna n.12/A (c.f.DNG MRC 75M20 A662W), il quale mi dichiara di essere maggiorenne, con piena capacità giuridica e di agire, e di essere coniugato in regime patrimoniale di separazione dei beni, identificato dalla patente di guida n.BA2827738M, rilasciata il giorno 12 agosto 1994, in corso di validità.

Il medesimo, della cui identità personale io notaio sono certo, mi richiede di ricevere il presente atto con il quale, nella veste di socio unico della società costituenda, di cui appresso, nomina procuratrice speciale la signora Elisa Shkurtaj, paternità Skënder, nata il 23 ottobre 1997 a Vranisht (Albania) e residente a Tirana (Albania), maggiorenne e con piena capacità giuridica e di agire, titolare del passaporto albanese numero BG0258332 e con numero personale



J76023040K, alla quale conferisce piena facoltà e poteri, di eseguire azioni, applicazioni e servizi, in suo nome e per suo conto, presso il notaio (per sottoscrivere l'atto di costituzione e lo statuto della società) nonché al Centro Nazionale del Business, a Tirana, Albania, per la costituzione della società a responsabilità limitata, con i dati come riportati qui sotto:

1. Denominazione della società: WISDOM (Se nel frattempo tale denominazione sarà già utilizzata, quindi impossibile ad essere usata per la costituenda società, la procuratrice speciale può scegliere altra denominazione);
2. Forma della società: società a responsabilità limitata;
3. Oggetto dell'attività: creazione website, e-commerce, applicazioni e social network, pubblicità, cataloghi, logo, marketing, studi e ricerche di mercato, ricerca clienti e fornitori, elaborazione dati; compravendita di abbigliamento, elettronica, arredi, auto e moto, servizi consulenza, gestione pacchetti viaggio e turistici, servizi finanziari, call center;
4. Sede: Rruga "Bako Dervishaj", Nd. 8, H. 2, Ap. 6, Njësia Administrative nr. 2, 1010 Tirana (Albania);
5. Capitale sociale iniziale: 100 euro;
6. Amministratore: Elisa Shkurtaj, nata il 23 ottobre 1997 a Vranisht (Albania) e residente a Tirana (Albania), titolare del passaporto albanese numero BG0258332 e con numero perso-

nale J76023040K.

La procuratrice speciale rappresenterà il mandante presso il Centro Nazionale del Business per l'iscrizione della società sopra descritta, nella quale il mandante sarà titolare dell'intero capitale sociale, per depositare l'atto costitutivo e lo statuto della società in corso di costituzione, da essa sottoscritti, in nome e per conto del mandante in qualità di socio, per presentare e firmare la domanda presso il Centro Nazionale del Business, effettuare i pagamenti richiesti per l'iscrizione, in seguito per ritirare l'estratto di iscrizione presso il Centro Nazionale del Business per la società, nonché il relativo certificato di iscrizione con il NIPT (partita IVA) della stessa.

All'uopo, la procuratrice potrà agire presso tutti gli organi della pubblica amministrazione, centrale o locale, istituzioni statali, nonché presso tutti gli organi giudiziari, in ogni caso e per qualsiasi motivo necessario, e per azioni che si collegano a questi enti, sempre in qualità del socio della suddetta società, nonché per tutti i problemi che possano sorgere con questi enti, avendo piena facoltà e poteri di richiedere informazioni davanti a questi enti, di fornire informazioni, firmare tutti i documenti necessari e indispensabili, in nome e per conto del mandante.

Tutti gli atti che la procuratrice eseguirà in relazione a quanto sopra, dovranno essere considerati giusti e necessari


come se fossero stati eseguiti dal mandante stesso e saranno validi ed efficaci senza bisogno di ratifica o conferma.

Questa procura speciale è a tempo indeterminato, valida fino a revoca del mandante.

Richiesto ho redatto il presente atto del quale ho dato lettura al comparente che, da me interpellato, lo ha approvato.

Dattiloscritto da persona di mia fiducia, occupa tre facciate intere e quanto della quarta fin qui di un foglio.

Domenico Accoruso
Notario



Apostille

(Convention de la Haye du 5 octobre 1961)

1. Paese: ITALIA

Il presente atto pubblico

2. è stato sottoscritto da *DOMENICO ACCORUSO*

3. agente in qualità di *NOTAIO*

4. è munito del contrassegno / timbro *ACCORUSO DOMENICO DI RICHIESE*
NOTAIO IN BARI

ATTESTATO

5. a Bari

7. dalla Procura della Repubblica

6. il

15 SET. 2020

8. sotto il n. *736/2020*

9.

10. IL PROCURATORE DELLA REPUBBLICA



Giuseppe Marafia

Giuseppe Marafia

Luigi Marafia

Repertorio n. 12.553

PROKURË E VEÇANTË

REPUBLIKA E ITALISË

Viti dy mijë e njëzet, në ditën e tetë të muajit shtator,

- 8 shtator -

në Bari, në studion time në Via Piccinni n. 51;

përpara meje doktor Domenico Amoruso, Noter në Bari, i regjistruar në Kolegjin Noterial të Rrethit të Bari;

është prezent

Marco D'ANGELO, shtetas italian, atësia Rocco, lindur më 20.08.1975 në Bari dhe banues në Bari-Carbonara (Itali), në Via dei Caduti della Strage di Bologna n. 12/A (kodi fiskal DNG MRC 75M20 A662W), i cili më deklaron se është madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, të jetë i martuar në regjimin pasuror të ndarjes së pasurive, i identifikuar me anë të lejes së drejtimit të automjetit nr. BA2827738M, lëshuar më 12 GUSHT 1994, e vlefshme akoma;

Personi i lartpërmendur, për identitetin e të cilit unë noteri jam i sigurtë, më kërkoi lëshimin e kësaj prokure, me anë të së cilës, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë që do të krijohet, të cilën do ta përshkruaj më poshtë, emëroj si përfaqësuese time të posaçme Znj. Elisa Shkurtaç, atësia Skënder, lindur më 23.10.1997 në Vranisht (Shqipëri) dhe banuese në Tiranë (Shqipëri), madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e pasaportës shqiptare me numër BG0258332 dhe me numër personal J76023040K, të cilës i jep të drejtë dhe kompetencë të plotë, që të kryejë veprime, aplikime dhe shërbime, në emër dhe për llogarinë time, pranë noterit dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, në Tiranë, Shqipëri, për themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me të dhënat e mëposhtme:



1. Emri i shoqërisë: **WISDOM** (Nëse ndërkohë emri i zgjedhur nga unë do të jetë i përdorur më parë dhe i pamundur për tu përdorur për shoqërinë tonë, përfaqësuesja ime mund të zgjedhë një emër tjetër);

2. Forma e shoqërisë: shoqëri më përgjegjësi të kufizuar;

3. Objekti i aktivitetit: Krijimi i website-ve, e-commerce, aplikacioneve dhe rrjeteve sociale, publicitet, katalogje, logo, marketing, studim dhe kerkim tregu, kerkim klientesh dhe furnitresh, përpunim të dhenash, shitblerje e veshjeve, produkteve elektronike, mobiljeve, makinave etj., shërbim konsulence, menaxhim/ krijim paketash turistike dhe udhëtimesh, shërbime financiare, call center;

4. Selia: "Rruga" Bako Dervishaj", Nd. 8, H. 2, Ap. 6, Njësia Administrative nr. 2, 1010 Tiranë (Shqipëri);

5. Kapitali fillestar: 100 Euro;

6. Administratori: Elisa Shkurtaj, lindur më 23.10.1997 në Vranisht (Shqipëri) dhe banuese në Tiranë (Shqipëri), mbajtëse e pasaportës me nr. BG0258332 dhe me nr. personal I76023040K.

Përfaqësuesja e posaçme do të përfaqësojë të përfaqësuarin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për rregjistrimin e shoqërisë të përshkruar më sipër, ku i përfaqësuarit do të jetë zotëruar i të gjithë kapitalit të shoqërisë, për të depozituar aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë në krijim e sipër të nënshkruar prej saj, në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, në cilësinë e ortakut, të nënshkruajë aplikimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit, të kryejë pagesat e kërkuara për rregjistrim, të tërheqë ekstraktin e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit për shoqërinë në fjalë si edhe certifikatën përkatëse të rregjistrimit me NIPT të kësaj shoqërie.

Përfaqësuesja e zgjedhur ka të drejtë të veprojë pranë të gjitha Organeve të Administratës Shtetërore, Lokale, institucioneve të ndryshme të Administratës shtetërore, si dhe në organet e ndryshme gjyqësore, për çdo rast dhe për çdo arsye që është e nevojshme, si për veprimet që e lidhin me këto organe, gjithmonë në cilësinë e ortakut të shoqërisë së sipërpërmendur, ashtu edhe për të gjitha problemet që lindin me këto organe, duke patur tagra dhe të drejta të plota për të



kërkuar informacion përpara këtyre organeve, të japë informacion, kur është e nevojshme, të nënshkruajë të gjitha dokumentat e nevojshme dhe të domosdoshme, në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit.

Të gjitha veprimet që do të kryejë përfaqësuesja, në lidhje me sa më sipër, do të konsiderohen të drejta dhe të mirëqena, njëloj sikur të lshin kryer prej të përfaqësuarit dhe do të jenë të vlefshme e të efektshme pa pasur nevojë për ratifikim dhe konfirmim të metejshëm.

Kjo prokurë është është e pakufizuar në afat kohor, e vlefshme deri në revokimin e saj nga ana e të përfaqësuarit.

Kam hartuar këtë akt të kërkuar, të cilin e kam lexuar para klientit i cili, i pyetur nga unë, e ka aprovuar.

I shkruajtur nga person i besuar i imi, shtrihet në tre faqe të plota dhe të katërtën deri këtu.

Marco D'Angelo

Firma



Apostile
(Konventa e Hagës e 5 tetorit 1961)

1. Vendi : **ITALI**

Ky dokument publik

2. është bënshkruar nga **DOMENICO AMORUSO**

3. duke vepruar në cilësinë e **Noterit**

4. që mban vulën e **AMORUSO DOMENICO DI MICHELE**

NOTER NË BARI

VËRTETUAR

5. në **Bari**

6. më **15 SHTATOR 2020**

7. nga **PROKURORIA E REPUBLIKËS**

8. Nr. **736/2020**

9. Vula/ stampa

10. PROKURORI I REPUBLIKËS

PROKURORI I REPUBLIKËS I SHTUAR

Giuseppe Maralfa
Mëshihorëni

PROKURORIA
E REPUBLIKËS
-BARI-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER. NIKOLETA P. GJORDENI



DATE 10/10/2020
NR REP 4261

VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 10/10/2020, para meje Notere NIKOLETA P. GJORDENI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën MYSLYM SHYRI NR.30, u paraqit personalisht:

PËRKTHYES:

Arben Sulo, atësia Kujtim, amësia Xhemile, shtetas Shqiptar, lindur në Lushnjë, Lushnjë dhe banues në Tiranë, me adresë Sami Frasheri; Nd. 1827; H. 0; Ap. 100; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia bashkiake nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 28/04/1965, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 030845350 dhe nr. personal G50428103J,

Përkthyesi është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë dhe deklaroi se ka përkthyer saktësisht dhe me përgjegjësi ligjore dokumentat bashkëngjitur sipas origjinalit nga gjuha italiane në gjuhën shqipe dhe i ka nënshkruar ato rregullisht sipas ligjit.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroi se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
NIKOLETA P. GJORDENI

Noterë
Nikoleta P. Gjordeni
049



1234

5678